



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI  
KRYETARI

VENDIM

Nr. 2 datë 17.07.2020

**PËR MIRATIMIN E HEQJES DORË TË ANËTARES SË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI, ZONJËS FATJONA MEMÇAJ, NGA PJESËMARRJA NË VEPRIMTARITË DHE MBLEDHJET PËR PROCEDURAT E VERIFIKIMIT, VLERËSIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATURËS SË PARAQITUR NGA ZNJ.ARDITA BUNA, PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT NË GJYKATËN KUSHTETUESE, TË SHPALLUR NGA KUVENDI I REPUBLIKËS NË DATËN 28.08.2018 DHE RISHPALLUR NË DATËN 21.08.2019**

Në mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (në vijim KED) të datës 17.07.2020, ku në rendin e ditës përfshihej shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datë 21.08.2019, anëtarja e Këshillit znj. Fatjona Memçaj, informoi se ka vlerësuar që gjendet në kushtet e pengesës ligjore dhe të papajtueshmërisë për të marrë pjesë në procedurat e verifikimi, vlerësimit dhe renditjes së kandidatës së paraqitur nga znj.Ardita Buna (Alsula). Për rrjedhojë, bazuar në nenin 224 pika 2, dhe 227 pika 2, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016), i kërkoi Zëvendëskryetares së KED-së, e cila aktualisht ushtron funksionet e Kryetarit dhe drejton veprimtarinë e KED-së, të procedojë dhe të disponojë sipas ligjit për miratimin e heqjes dorë nga pjesëmarrja në mbledhjet dhe veprimtaritë lidhur me këto procedura.

Si shkak të kërkesës për të proceduar me akt për miratimin e dorëheqjes dhe mospërfshirjen e saj në veprimtaritë konkrete të sipërcituara të KED-së, anëtarja Fatjona Memçaj parashtroi rrethanën se me njëri nga kandidatet për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, zonjën Ardita Buna (Alsula) është në marrëdhënie të posaçme, meqënëse kjo kandidate është motra e bashkëshortit të saj. Në lidhje me ekzistencën e këtyre rrethanave, anëtarja e Këshillit znj. Fatjona Memçaj ka paraqitur në rastin e mëparshëm të heqjes dorë të miratuar për të njëjtin shkak me vendimin nr. 1, datë 14.02.2019 të Kryetarit të Këshillit, edhe certifikatën familjare përkatëse, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Njësisë Administrative nr.7 Tiranë, në të cilën pasqyrohet se kandidata e lartpërmendur, zonja Ardita Buna (Alsula) është motra e zotit Dashmir Alsula, bashkëshorti i anëtares së KED-së, znj. Fatjona Memçaj.

Në lidhje me këto rrethana konkrete të parashtruara nga anëtarja e Këshillit, znj. Fatjona Memçaj, në cilësinë e Zëvendëskryetares së KED-së vlerësoj se janë të zbatueshme rregullat e përcaktuara posaçërisht në ligjin nr.115/2016, i cili në nenin 223 parashikon se:

*“Anëtari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk mund të marrë pjesë në verifikimin e kushteve ligjore, vlerësimin e kriterëve profesionale dhe në renditjen e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese ose të kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, në qoftë se midis tij dhe kandidatit ekzistojnë marrëdhëniet e mëposhtme:*

*a) marrëdhënie martesore ose bashkëjetese;*

*b) marrëdhënie gjinie të afërt, përfshirë persona të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave; ose*

*c) marrëdhënie krushqie të afërt, përfshirë vjehërr, vjehrrë, dhëndër, nuse, kunatë, thjeshtër dhe njerë.”*

Gjithashtu, në bazë e për zbatim të këtij ligji edhe në Rregulloren e Brendshme të KED-së, në pikën 1 të nenit 14, parashikohet se:

*“1. Anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues, nëse ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, nuk merr pjesë në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit të lidhura me çështje që kanë për objekt përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e rregullave normative të shortit, verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatëve, si edhe në procedurat konkrete të shqyrtimit të kandidimeve për pozicionet vakante.”*

Nga ana tjetër, ligji nr.115/2016 dhe Rregullorja e Brendshme e KED-së kanë përcaktuar edhe mënyrën e procedimit në rastet kur evidentohet gjendja e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose pengesave ligjore të anëtarit të KED-së në raport me çështjet konkrete që ky Këshill është duke shqyrtuar ose programon të shqyrtojë në mbledhjet dhe veprimtaritë që janë në kompetencën e këtij Këshilli.

Kështu në pikën 2 të nenit 224, dhe në pikën 2 të nenit 227 të ligjit nr. 115/2016 parashikohet se:

*“Neni 224 -Heqja dorë*

.....

*2. Vendimi për pranimin e dorëheqjes së anëtarit merret nga Kryetari i Këshillit. Kur dorëheqjen e jep Kryetari, vendimi për pranimin e saj merret nga zëvendëskryetari.”*

*Neni 227-Zëvendëskryetari*

.....

*“ 2. Zëvendëskryetari ushtron të gjitha funksionet e Kryetarit në mungesë ose pamundësi të këtij të fundit.”*

Në bazë e për zbatim të këtij ligji, në Rregulloren e Brendshme të KED-së, në pikën 2 të nenit 14, parashikohet se:

*“2. Në rastin kur në lidhje me çështje të caktuara që trajtohen në veprimtaritë dhe mbledhjet e Këshillit, anëtari i Këshillit ose anëtari zëvendësues vjen në dijeni të rrethanave të tilla që, sipas ligjit, e vendosin atë vetë ose një anëtar tjetër, përpara njërit prej rasteve të papajtueshmërisë, konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore, njofton menjëherë Kryetarin e*

*Këshillit dhe deklaroi arsyet konkrete që sjellin pengesë për pjesëmarrjen në përgatitjen, diskutimin dhe miratimin e çështjes përkatëse.”.*

Nga urdhërimet dhe interpretimi i dispozitave ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, përbën kompetencë për Zëvendëskryetarin e Këshillit, që ushtron funksionet e Kryetarit, që kur vjen në dijeni, të procedojë me shqyrtimin e rastit dhe të vlerësojë, sipas ligjit, ekzistencën e shkaqeve ligjore, të cilat janë të zbatueshme në rrethanat konkrete të konstatuara kryesisht, të parashtruara nga vetë anëtarit i KED-së apo nga të tretë, mbi gjendjen e papajtueshmërisë, konfliktit të interesit apo pengesës ligjore të anëtarit të KED-së në përmbushjen prej saj/tij të detyrave apo kompetencave në KED për shqyrtimin e çështjeve të caktuara.

Në cilësinë e Zëvendëskryetarit të Këshillit, që aktualisht ushtron funksionet e Kryetarit, duke pasur parasysh shkaqet ligjore dhe rrethanat konkrete të parashtruara nga anëtarja e KED-së, znj. Fatjona Memçaj, dhe që gjejnë pasqyrim në aktin zyrtar të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, kam ardhur në përfundimin se anëtarja e KED-së znj. Fatjona Memçaj, me të drejtë informon dhe parashtron se gjendet objektivist në kushtet e papajtueshmërisë të parashikuar nga shkronja “c” e nenit 223 të ligjit nr. 115/2016, duke qenë në marrëdhënie të posaçme, si kunata e njëjës prej kandidatëve për pozicionin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Në përfundim të parashtrimeve të mësipërme, duke ushtruar kompetencën që më është ngarkuar nga pika 2 e nenit 224 dhe neni 227 i ligjit nr. 115/2016, në cilësinë e Zëvendëskryetares së KED-së, vlerësoj se duhet të pranohet dorëheqja e anëtares së KED-së, znj. Fatjona Memçaj nga pjesëmarrja e saj në veprimtaritë dhe mbledhjet e KED-së për procedurat e verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatës Ardita Buna (Alsula), që ka shprehur interes për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 224 dhe të pikës 2 të nenit 227 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

#### **VENDOSA:**

Pranimin e heqjes dorë të anëtares së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, znj. Fatjona Memçaj, nga pjesëmarrja në veprimtaritë dhe mbledhjet e këtij Këshilli mbi procedurat e verifikimit dhe të vlerësimit të kandidatës Ardita Buna (Alsula), që ka shprehur interes për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019.

